



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERËT PUBLIKË

### RREGULLORE PËR MEDIAN

Miratuar nga Mbledhja e Komisionerëve Publikë, me vendimin nr. 14, datë 10.10.2018

#### VENDOSI:

##### Neni 1

##### Shërbimi për median

1. Institucioni i Komisionerëve Publikë (IKP) do të mundësojë kushte të përshtatshme për gazetarët dhe ekipet e xhirimit në funksion të ushtrimit të misionit të tyre për informimin e publikut.
2. Institucioni i Komisionerëve Publikë ka emëruar Koordinatorin për Median, me të cilin mund të kontaktohet përmes telefonit ose *email*-it. Kontaktet e Koordinatorit janë të publikuara në faqen zyrtare të institucionit: <http://ikp.al/>
3. Gazetarët, të cilët do të ndjekin veprimtarinë e Institucionit të Komisionerëve Publikë, do të akreditohen me konfirmimin e institucioneve mediatike që përfaqësojnë.
4. Kontaktet midis Institucionit të Komisionerëve Publikë dhe përfaqësuesve të medias realizohen nëpërmjet Koordinatorit për Median.
5. Në faqen zyrtare të internetit publikohen të gjitha vendimet e Institucionit të Komisionerëve Publikë për të ushtruar ose jo ankim për vendimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

## **Neni 2**

### **Informimi i medias për seancën në Kolegjin e Apelimit**

1. Koordinator i medias informon gazetarët për seancat që do të zhvillohen në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit për shqyrtimin e ankimimeve të Komisionerëve Publikë.
2. Pas njoftimit të datës, Koordinator i Medias informon gazetarët, sipas kërkesës së tyre, mbi aspektet faktike të seancës.

## **Neni 3**

### **Informacioni në lidhje me vendimet e Institucionit të Komisionerëve Publikë**

Parashtrimi i çështjes nga Komisionerët Publikë, në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, publikohet në faqen zyrtare të institucionit, rast pas rasti. Gjithashtu publikohen edhe fakte me interes për publikun.

## **Neni 4**

### **Monitorimi dhe zbatimi i rregullores së medias**

Institucioni i Komisionerëve Publikë do të monitorojë zbatimin e kësaj rregulloreje.

## **KOMISIONERËT PUBLIKË**

**Florian Ballhysa**

**Darjel Sina**